ReMusica
PRISHTINA INTERNATIONAL FESTIVAL

# FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS
# REMUSICA 2018


Tel.: + 383 (0)49622260
Address: Kroi Bardhë D–V / 9 10000 Prishtinë KOSOVA
info@remusicafestival.com
www.remusicafestival.com


ReMusicaFestival
FestRemusica
ReMusicaFestival

# ReMusica
PRISHTINA INTERNATIONAL FESTIVAL
27.05>02.06.2018



17th edition
www.remusicafestival.com

**EDITORIAL**

Duke e ruajtur fizionominë e saj, të bazuar në gërshetimin e muzikës së re me atë të epokave të tjera, ato të barokut, klasicizmit dhe të romantizmit,Edicioni i 17 me rradhëi ReMusica–s sivjet bën një shtrirje më të madhe, duke u zgjëruar edhe në disa fusha të tjera të artit por edhe duke synuar diversifikimin e mëtejmë të publikut.

Edicionin e sivjemë,më 27 maj, do ta hapkitaristi i mirënjohur kosovar Petrit Çeku,i cilësuar në shtypin e shumë qendrave botërore si "gjeniu i kitarës". Ai kësaj rradhe paraqitet në duo me Marc Bouchkov, violinist virtuoz belg, i cili është duke pushtuar furishëm sallat prestigjioze europiane duke bashkëpunuar me orkestrat më me nam të Europës, si Orkestra Nacionale të Belgjikës, Orkestra e Brukselit, Orkestra e Moskës, etj. Ata do të shpalosin një literaturë të veçantë, gjithnjë e më të preferuar në jetën muzikore të sotme, të shkruar për këto dy instrumente. Nata e dytë do t'i takoj sekstetit vokal proMODERN nga Polonia, që shquhet me një këndim të rafinuar, stilistikisht të diferencuar dhe me kulturë të lartë vokale. Ata do ta shfaqin projektin e tyre Shakespired, të sajuar prej veprave të stilit të barokut, me sonetat e Shekspirit, që gërsheton poezinë e shekullit 16 dhe muzikën moderne. Frymën e barokut edhe këtë vit do e sjell ansambli i përbërë prej solistëve tanë të talentuar vokal, në koncertin vijues të quajtur Prishtina Baroque Night. Ky ansambël tash e disa vite paraqitet në ReMusica dhe ngadal por bindshëm është duke u formësuar si një ansambël kompakt dhe atraktiv i përkushtuar në mënyrë specifike muzikës së barokut. Nata Shqiptare, segmenti pandashëm tematik i festivalit, këtë vit sjell në pah autorët dhe interpretët nga Kosova dhe Shqipëria. Programi i këtij koncerti është i ndërtuar mbi tri shtylla kryesore: a) Vepra pianistike dhe kamertale të autorëve tanë, b) Vepra për instrumente frymore, interpretuar nga kuinteti All about wind... instruments! dhe c) Vepra korale të autorëve tanë interpretuar nga Siparantum Choir nga Peja.

ReMusica Junior dhe Nata Akusmatike edhe këtë vit synojnë promovimine muzikës akusmatike dhe botës tingullore të saj. Programi është i përbërë nga veprat e kompozitores Donika Rudi, të cilat zbulojnë strukturat dhe shtresat tingullore në hapësirë.

Këtë vit ReMusica,krahas koncerteve të mbrëmjes,sjell segmente të reja përmbajtësore dhe programe shtesë, si 'ReMusica Edukative', ku publiku në mënyrë të drejtpërdrejtë do të jetë afër me muzikën, interpretin, instrumentin dhe kompozitorin duke u njohur me zejen dhe teknikën e zejes së tyre. Publiku, i përbërë prej fëmijëve trevjeçar e tutje, do ta ketë mundësinë të shijojë koncertet e shkurtëra dedikuar instrumenteve të veçanta. 'ReMusica Virtuale'në fokus ka inovacionin dhe zhvillimet e fundit të teknologjisë së përdorur në muzikë, andaj ReMusica sjell një aktivitet specifik që ka për synim që nëpërmjet syzeve të Realitetit Virtual (Virtual Reality) të projektoj publikun në mënyrë virtuale, në koncertet e skenave të mëdha botërore. Programi tjetër shteseështë 'ReMusica n'Shesh' që synon të përafroj publikun e gjerë me muzikën në këndin e festivalit në sheshin "Zahir Pajaziti", ku për çdo ditë për dy orë rresht, do të ketë dëgjim të muzikës klasike dhenjëkohësisht publiku do të ketë mundësi të dëgjoj dhe të merr informacionedirekt nga artistët që do të performojnë në netët kryesore, të mbrëmjes, të ReMusica–s. Në zgjërimin e saj pëmbajtësor festivali sivjet promovon programin 'PRE ReMusica', në të cilin do të shfaqet filmi dokumentar "Sarabandë", me regji të autores Kaltrina Krasniqi, ku ajo në mënyrë origjinale e portretizon virtuozin Petrit Çeku gjatë inçizimeve të Suitave të Bahutnë një Studio në Spanjë në vitin 2014.

Koncertet në bashkëpunim me Filharmoninë e Kosovës mbesin tëçmueshme dhe shumë të veçanta të programit tonë. Orkestra e Filharmonisë së Kosovës me solist Marc Bouchkov dhe dirigjentin Toshio Yanagisawa, sjellin repertoar nga epoka të ndryshme. Kurse Kori i Filharmonisë së Kosovës medirigjentin Rafet Rudi sjellin një program ta përpiluar kryesisht me vepra të autorëve shqiptarë, të prezentuara me shumë sukses ditë më parë në turneun e këtij ansambli në Angli.

Në ReMusica gjithmonë i është dhënë rëndësi diskutimit të çështjeve të rëndësishme, andaj festivali vendosë që nivelin e diskutimit ta ngritë në nivel ndërkombëtar, duke sjellë përfaqësues të institucioneve muzikore kyçe nga Europa dhe rajoni, me fokus në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Së fundmi, sivjet ReMusica theksin e ka në krijimtarinë e kompozitorëve kosovar andaj edhe do të sjellë për çdo natë vepra të autorëve kosovarë, me fokus në përvjetorët e dy kompozitorëve tanë të çmuar, 95 vjetorin e lindjes sëRexho Mulliqit dhe 60 vjetorin e lindjes së Mendi Mengjiqit.

ReMusica
Prishtina International Festival
27.05>02.06.2018

**EDITORIAL**

Having its physiognomy as a guidance point, based on interweaving of new music with music from different eras, as are baroque, classicism, and romanticism, 17 Edition of ReMusica Festival stretches its reach to other artistic fields, and further works on public diversification.

The Opening of the festival will be done on 27 May by a well–known Kosovar guitarist Petrit Çeku, considered by many critics as a 'guitar genius'. At this event he will be a part of a duo with a virtuous Belgian violinist Marc Bouchkov, who is conquering prestigious European concert halls through collaborations with Belgian National Orchestra, Brussels Orchestra, Moscow Orchestra, and so on. They will have a display of special works dedicated to their instruments, much appreciated by today's public. The second concert night belongs to proMODERN vocal sextet from Poland, known for their refined singing, stylistic diversity, and high vocal skills. They will present their project called Shakespired, which is an extraordinary project combining 16th–century poetry with contemporary music. The baroque spirit this year will be brought again at ReMusica by a vocal ensemble at the concert night called Pristina Baroque Night. The ensemble is composed of talented soloists, who have formed a compact and attractive ensemble, specifically devoted to the baroque music. Albanian Night, inseparable thematic segment of the festival, brings Kosovar and Albanian authors and artists. The concert programme is based on three pillars: a) piano and chamber pieces of our composers; b) pieces for wind instruments, interpreted by a quintet called All about wind… instruments!; and c) choral works of our composers interpreted by the Siparantum Choir from Peja.

ReMusica Junior and the Acousmatic Night this year aim to further promote the acousmatic music, and its sound world. The programme is comprised of works by Donika Rudi which uncover the sound structure and its layers in space.

Beside the evening main concert events, ReMusica brings new substantial segments and programmes, as is Educational ReMusica, aiming at closing the gap between the public and the music, interpreter, instrument, and the composer, by getting to know their craft and technique from up–close. The public, especially the youngsters, will have the opportunity to enjoy short concerts dedicated to selected instruments. Virtual ReMusica focuses on latest technological innovation, as is the VR (Virtual Reality), and its intent is to project the public virtually to concert events in some of most prestigious concert halls. Furthermore, through ReMusican'Shesh, the festival aims at bringing the music to the public, through a musical corner at ZahirPajaziti square. Each day for two hours the public will have the opportunity to listen to the classical music, and get to know the artists preforming at the main concert events, as well as general information regarding the festival. In everlasting substantial expansion of the festival activities, through a segment called PRE ReMusica, the festival brings a screening of Sarabandë, a documentary directed by KaltrinaKrasniqi, which through a unique form portrays the virtuous PetritÇeku during his Bach Suites recordings in a studio in Spain in 2014.

Cooperation concerts with Kosovo Philharmonics are still a valuable and special part of the festival's programme. The Kosovo Philharmonic Orchestra, with Marc Bouchkov as a soloist, under the direction of Toshio Yanagisawa, bring a diverse repertoire. While the Kosovo Philharmonic Choir, under the baton of Rafet Rudi, brings a programme mainly comprised of Albanian composers works, which were recently presented on their tour in England.

ReMusica always initiated important discussions regarding the happenings in the music world, a tradition which the festival brings to a higher level at an international conference, whose participants will be regional and European stakeholders.

At last, but not least, the programme of this year's Edition will focus on compositions of local composers, and celebrates the 95 birth anniversary of Rexho Mulliqi, and 60 birth anniversary of Mendi Mengjiqi.

Drejtoreshë e Festivalit
**Donika Rudi**



ReMusica
PRISHTINA INTERNATIONAL FESTIVAL
27.05>02.06.2018

E premte / Friday **25** MAJ Pre–ReMusica
18:00 Cineplexx
Film & Muzikë: Sarabandë
Starring: Petrit Çeku | Directed By: Kaltrina Krasniqi | Music & Sound Design: Donika Rudi

E diel / Sunday **27** MAJ
11:30 Sheshi "Zahir Pajaziti"
ReMusica N'shesh

**Hapja / Opening of ReMusica Festival 2018**
20:00 Amfiteatri i Ri i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare
**PETRIT ÇEKU** kitarë / guitar
**MARC BOUCHKOV** violinë / violin

E hënë / Monday **28** MAJ
11:30 Sheshi "ZahirPajaziti"
ReMusica N'shesh: Grup vokal iso–polifoni "Bilbili"

10:00 Hotel Prishtina
Konferenca Ndërkombëtare "Festivalet: Perspektiva Ballkanike dhe Europiane"

20:00 Amfiteatri i Ri i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare
**SHAKESPIRED proMODERN** sekstet vokal / contemporary vocal sextet

E martë / Tuesday **29** MAJ
10:30 Amfiteatri i Ri i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare
ReMusica Edukative: Profili i kontratenorit | Safet Berisha, kontratenor

20:30 Salla e Kuqe / Red Hall
**ORKESTRA E FILHARMONISË SË KOSOVËS** / KOSOVO PHILHARMONIC ORCHESTRA (koncert në bashkëpunim me Filharmoninë e Kosovës)
**Marc BOUCHKOV** violinë / violin
**Toshio YANAGISAWA** dirigjent / conductor

E mërkurë / Wednesday **30** MAJ
10:30 Amfiteatri i Ri i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare
ReMusica Edukative: Instrumentet frymore
Trio Sonore: Meriton Ferizi, fagot/bassoon| Lejla Beqiri, flaut/flute|Pellumb Vula, klarinet/clarinet | Albin Abazi obo/oboe

11:30 Amfiteatri i Ri i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare
ReMusica Junior: Udhëtim tingullor | Donika Rudi, spacializuese

ReMusica
PRISHTINA INTERNATIONAL FESTIVAL
27.05>02.06.2018



20:00 Amfiteatri i Ri i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare
**NATA AKUSMATIKE / ACOUSMATIC NIGHT**

Koncert autorial Donika RUDI
**Donika RUDI** Spacializuese/spacializer

E enjte / Thursday **31** MAJ
11:30 *Sheshi "ZahirPajaziti"*
ReMusicaN'shesh: Siparantum Choir

20:00 *Amfiteatri i Ri i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare*
**NATA SHQIPTARE**
Kompozitorë dhe Interpretë shqiptarë

I Vepra pianistike dhe kamertale
Klevis Gjergji, piano
Trio Sonore

II All about wind … instruments!
Kuintet pianistik: Meriton Ferizi, fagot/bassoon | Pëllumb Vula, klarinet/clarinet|
Lejla Beqiri, flaut/flute| Bledar Bujupi, kornë / corno
Albin Abazi, obo/oboe| Melos Buza, piano

III Vepra korale
SIPARANTUM CHOIR, dirigjent/conductor Memli Kelmendi

E premte / Friday **1** QERSHOR
20:00 Kisha Katolike "Shën Ndou"
**PRISHTINA BAROQUE NIGHT**
Safet Berisha, kontratenor/countertenor | Kaltrina Miftari, soprano|
Donika Rushiti mezzosopran | Shaban Behramaj, bas
AdorelHaxhiaj, violoncelo/cello |Artemida Qarri, piano

E shtunë / Saturday **2** QERSHOR
20:30 Kisha Katolike "Shën Ndou"
**KORI I FILHARMONISË SË KOSOVËS** / KOSOVO PHILHARMONIC CHOIR
**Rafet RUDI** dirigjent/conductor



E diel **27** MAJ

## Hapja / Opening

**20:00** Amfiteatri i Ri i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare

## PETRIT ÇEKU kitarë/guitar
## MARC BOUCHKOV violinë/violin

**Niccolò Paganini**
Cantabile

Sonata No. 1 in A minor, from "Centone di Sonate", M. 112
*Introduzione: Larghetto / Tempo di marcia: Allegro maestoso Rondoncino*

**Béla Bartók**
Romanian Folk Dances
*Bot tánc (Stick Dance) / Brâul (Sash Dance) / Topogó (In One Spot)*
*Bucsumí tánc (Dance from Bucsum) / Román polka (Romanian Polka)*
*Aprózó (Fast Dance)*

**Rafet Rudi**
Këngë Labe
Ta dish
Një zet e pesë gërsheta (Korçare) & Double

**Jules Messenet**
"Méditation"
*from the opera "Thaïs"*

**Astor Piazzolla**
Histoire du Tango
Bordel
Café
Nightclub
Concert d'aujourd'hui

RéMusica PRISHTINA INTERNATIONAL FESTIVAL 27.05>02.06.2018

**PETRIT ÇEKU** – Sensibiliteti dhe ekspresiviteti i Petrit Çekut ka tërhequr vëmendjen e audiencave në gjithë botën. Ai u paraqit me recitale solistike në mbarë Europën dhe Amerikën Veriore si dhe në koncerte nën përcjelljen e orkestrave simfonike si *Allentown Symphony, Baltimore Symphony, Orkestra Kamertale e Filharmonisë Çeke, Orkestra Shtetërore e Hermitazhit të St. Petersburgut* dhe *Filharmonia e Zagrebit.* Ai gjithashtu ka bashkëpunim të vazhdueshëm me ansamblin e famshëm kamertal *Solistët e Zagrebit* dhe është themelues i trios kitaristike *Elogio.*
I cilësuar nga kritiku i kitares Colin Cooper si "solist i aftësive më të larta", Çeku ka fituar 9 çmime të para në garat ndërkombëtare kitaristike, përfshi edhe *Parkening Competition* në Malibu, SHBA (2012). Ai gjithashtu fitoi në *Schadt Competition* në Allentown, SHBA (2011), *Maurizio Biasini* në Bologna, Itali (2011), si dhe *Pittaluga Competition* në Alessandria të Italisë (2007).
I lindur në Prizren, Çeku filloi edukimin muzikor në klasën e Luan Sapunxhiut. Në vitin 2002 u bart në Zagreb, ku u ftua që të vijojë studimet me Xhevdet Sahatçiun. Në vitin 2008, Çeku diplomoi në Akademinë e Muzikës në Zagreb, në klasën e Darko Petrinjakut. Në vitet 2009–2013, duke realizuar ëndrrën e tij, ai rafinoi zanatin me kitaristin e famshëm Manuel Barrueco në Konzervatorin *Peabody* në Baltimore, SHBA.
I konsideruar ndër kitaristët më të mirë të gjeneratës së tij, inçizimi i parë i Petrit Çekut u lansua në vitin 2008 nën etikën amerikane *Naxos.* Po atë vit ai mori çmimin vjetor "Artisti i ri më i mirë" nga Filharmonia e Zagrebit. Inçizimi i tij i të gjitha Suiatave për violonçel të Johann Sebastian Bachut, të aranzhuara nga Valter Deshpalli, u publikuan në maj të vitit 2015 nën ombrellën e shtëpisë botuese spanjolle *Eudora Records.*
Petrit Çeku luan në kitarën e mjeshtrit Ross Gutmeier.
I lindur në Prizren, Çeku filloi edukimin muzikor në klasën e Luan Sapunxhiut. Në vitin 2002 u bart në Zagreb, ku u ftua që të vijojë studimet me Xhevdet Sahatçiun. Në vitin 2008, Çeku diplomoi në Akademinë e Muzikës në Zagreb, në klasën e Darko Petrinjakut. Në vitet 2009–2013, duke realizuar ëndrrën e tij, ai rafinoi zanatin me kitaristin e famshëm Manuel Barrueco në Konzervatorin Peabody në Baltimore, SHBA.
I konsideruar ndër kitaristët më të mirë të gjeneratës së tij, inçizimi i parë i Petrit Çekut u lansua në vitin 2008 nën etikën amerikane Naxos. Po atë vit ai mori çmimin vjetor "Artisti i ri më i mirë" nga Filharmonia e Zagrebit. Inçizimi i tij i të gjitha Suiatave për violonçel të Johann Sebastian Bachut, të aranzhuara nga Valter Deshpalli, u publikuan në maj të vitit 2015 nën ombrellën e shtëpisë botuese spanjolle Eudora Records. Petrit Çeku luan në kitarën e mjeshtrit Ross Gutmeier.

**MARC BOUCHKOV**–Mjeshtëria e Marc Bouchkovit nxitet nga të shprehurit. Loja e tij në violinë lidhet jo vetëm me njohurinë e thellë të pjesës që luan, përmbajtjen historike dhe interpretimin e mirëfillt, por edhe në besimin e tij që performanca është një mënyrë e komunikimit të drejtëpërdrejtë me dëgjuesin. Afërsia që ka tingulli i violinës me zërin e njeriut shërben si frymëzim për shprehjen e ndjenjave dhe emocioneve në muzikë, duke e shëndrruar ate në përvojë për publikun. Marc Bouchkov lindi më 1991 dhe vjen nga një familje violinistësh. Mësimet e para i zuri në moshën pesë vjeçare me gjyshin e tij, Mattis Vaitsner. Studioi me Claire Bernard dhe Boris Garlitzky, i cili është edhe mentor i tij edhe në ditët e sotme.
Zhvillimi artistik i Marc Bouchkovit është vlerësuar me çmime ndërkombëtare të shumta. Fitoi Çmimet e Para të garës së vlerësuar lartë "Gara Ndërkombëtare e Violinës Henri Koch", "Audicioni i Artistëve të Rinjë Europian", "Gara Queen Elizabeth", "Gara Ndërkombëtare Muzikore e Montrealit", është emëruar si fitues i Stiftung Juventus nga Georges Gara dhe pranoi "Lotto–Förderpreis" nga Festivali i Muzikës së Rheingau. Nga 2014 deri më 2017 Bouchkov studio si Solist i Ri në kursin postdiplomik në Akademinë Kronberg me Mihaela Martin. Si concertant shijoi rritjen dhe mirënjohjen e karrierës së tij. "Pa mëdyshje: talent i jashtëzakonshëm!" u shkrua në Neue Zurcher Zeitung pas koncertit me Tonhalle Orchester Zürich. Kulmi i sezonit 2016/2017 përfshinë koncertet me Hr Sinfonieorchester dhe Christoph Eschenbach, Orkestra Kombëtare e Belgjikës dhe Orkestra Simfonike Kombëtare RAI në Torino nën dirigjimin e Andrey Boreyko.

Bouchkov performoi me NDR–Sinfonieorchester Hamburg, Orkestrën Kombëtare të Belgjikës, Orkestrën e Filharmonisë Mbretërore të Liezhës, Moskës, Filharmoninë Staatsorchester Rheinische dhe Simfoninë Düsseldorfer. Bouchkov performoi në koncertin themelues të serive "Essentials" të Orkestrës Mbretërore Concertgebouw.Në tetor të vitit 2016 debutoi në Wingmore Hall të Londrës, ku u shpërblye me çmimin London Music Masters. Sezoni 2017/2018 për Bouchkovin filloi me publikimin e albumin e tij të parë me punime të Ysaye, Chausson dhe të tija dhe në vitin 2017 u shpërmbyle me Diapason Découverte dhe u nominua për ICMA 2018. Pikat tjera me rëndësi përfshijnë vazhdimin e bashkëpunimit të tij me Düsseldorf Ballet, koncertet orkestrale duke përfshirë këtu MDR Orkestrën, Orkestrën e Filharmonisë Mbretërore të Liezhës, Orkestrën Kombëtare të Lorriane, si dhe recitalet dhe koncertet e muzikës kamertale në Paris, Lucern, Lugano, si dhe në Festivalin Rheingau. Marc Bouchkov sponzorohet nga Brigitte Feldtmann, e cila i dhuroi violinën punuar nga Jean Baptiste Vuillaume, Paris, 1865.



## E hënë 28 MAJ

**20:00** Amfiteatri i Ri i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare

# SHAKESPIRED

## proMODERN sekstet vokal / vocal sextet

Marta Czarkowska, soprano | Ewa Puchalska, mezzo–soprano | Ewelina Rzezinska, mezzo–soprano
Andrzej Marusiak, tenor | Krzysztof Chalimoniuk, baritone | Piotr Pieron, bass

**KrzesimirDębski**
From fairest creatures we desire increase (Sonnet 1)
When forty winters shall besiege thy brow (Sonnet 2)

**Krzysztof Herdzin**
Shall I compare thee to a summer's day? (Sonnet 18)

**Dariusz Przybylski**
A woman's face with Nature's own hand painted (Sonnet 20)

**Krzysztof Herdzin**
Let those who are in favour with their stars (Sonnet 25)

**PawełŁukaszewski**
"Weary with toil" (Sonnet 27)

**WłodekPawlik**
Full many a glorious morning have I seen (Sonnet 33)

**Andrzej Borzymjr**
Those pretty wrongs that liberty commits (Sonnet 41)
Being your slave, what should I do but tend (Sonnet 57)
No longer mourn for me when I am dead (Sonnet 71)

**Philip Lawson**
"To me, fair friend" (Sonnet 104)

**Miłosz Bembinow**
"Th' expense of spirit" (Sonnet 129)

**Aleksander Kościów**
"O, call not me..." (sonnet 139)

**Miłosz Bembinow**
"Love is too young" (sonnet 151)

**Mendi Mengjiqi**
OEIA

**proMODERN** sekstet vokal – Gjashtë vitetet e ekzistencës së tyre ishin një rrugëtim i pandërprerë suksesi. Gjatë kësaj kohe seksteti vokal proMODERN publikoi dy albume të tyre, inçizoi muzikë për dy të tjera, prezantoi premiera botërore të 28 kompozimeve (përfshirë miniaturë, forma të mëdha a cappella, vepra vokalo–instrumentale dhe vepra për vokal dhe orkestër, si dhe 9 cikle të ndryshme të këngës), performuan në festivale dhe u ftuan në qendra kryesore kulturore, përfshirë shumicën e orkestrave filharmonike të Polonisë.

Më 2015 proMODERN fitoi dy çmime Fryderik të industrisë muzikore të polake, në kategorinë e "Albumin e Vitit të Muzikës Korale, Oratore dhe Operistike" si dhe "Inçizimin më të Mirë të Muzikës Polake" për albumin e tyre debutues *Where Are You? Pieces from Warsaw*. Albumi i dytë, *proMODERN Shakespired,* u publikua në dhjetor të vitit 2017 dhe vepra e Philip Lawson, të cilën artisti legjendar e kompozoi si porosi enkas për grupin, brenda dy jave, pati mby 19,000 dëgjime në Spotify! Albumi u nominua dhe fitoi dy çmime të Fryderyk në 2018, në kategorinë "Albumi i Vitit i Muzikës Kontemporane" si dhe në kategorinë "Inçizimin më të Mirë të Muzikës Polake".

Ansambli u themelua nga solistët vokal lider, që ndajnë pasion dhe aftësi për interpretim të pjesëve më të vështira të kompozitorëve të sodit. proMODERN njihet si sinonim i performancave më të mira vokale të muzikës kontemporane. Ansambli çmohet lartë nga komuiniteti muzikor dhe ka rencensione të shkëlqyera.

proMODERN:
Marta Czarkowska, soprano
Ewa Puchalska, mezzo–soprano
Ewelina Rzezińska, mezzo–soprano
Andrzej Marusiak, tenor
Krzysztof Chalimoniuk, baritone
Piotr Pieron, bass







E martë **29** MAJ

ReMusica
PRISHTINA INTERNATIONAL FESTIVAL
27.05>02.06.2018

**20:30** Salla e Kuqe / Red Hall

## ORKESTRA E FILHARMONISË SË KOSOVËS
### KOSOVO PHILHARMONIC ORCHESTRA

**Marc BOUCHKOV violinë /violin**
**Toshio YANAGISAWA dirigjent /conductor**

**Rexho Mulliqi** (95 vjetori i lindjes)
Simfonia nr. 1

**Felix Mendelssohn**
Violin Concerto in e–minor

**Marc Bouchkov,** violinë/violin

**Sergei Prokofiev**
Romeo and Juliet

**MARC BOUCHKOV** –Mjeshtëria e Marc Bouchkovit nxitet nga të shprehurit. Loja e tij në violinë lidhet jo vetëm me njohurinë e thellë të pjesës që luan, përmbajtjen historike dhe interpretimin e mirëfillt, por edhe në besimin e tij që performanca është një mënyrë e komunikimit të drejtëpërdrejtë me dëgjuesin. Afërsia që ka tingulli i violinës me zërin e njeriut shërben si frymëzim për shprehjen e ndjenjave dhe emocioneve në muzikë, duke e shëndrruar ate në përvojë për publikun. Marc Bouchkov lindi më 1991 dhe vjen nga një familje violinistësh. Mësimet e para i zuri në moshën pesë vjeçare me gjyshin e tij, Mattis Vaitsner. Studioi me Claire Bernard dhe Boris Garlitzky, i cili është edhe mentor i tij edhe në ditët e sotme.
Zhvillimi artistik i Marc Bouchkovit është vlerësuar me çmime ndërkombëtare të shumta. Fitoi Çmimet e Para të garës së vlerësuar lartë "Gara Ndërkombëtare e Violinës Henri Koch", "Audicioni i Artistëve të Rinjë Europian", "Gara Queen Elizabeth", "Gara Ndërkombëtare Muzikore e Montrealit", është emëruar si fitues i Stiftung Juventus nga Georges Gara dhe pranoi "Lotto–Förderpreis" nga Festivali i Muzikës së Rheingau. Nga 2014 deri më 2017 Bouchkov studio si Solist i Ri në kursin postdiplomik në Akademinë Kronberg me Mihaela Martin.

Si concertant shijoi rritjen dhe mirënjohjen e karrierës së tij. "Pa mëdyshje: talent i jashtëzakonshëm!" u shkrua në Neue Zurcher Zeitung pas koncertit me Tonhalle Orchester Zürich. Kulmi i sezonit 2016/2017 përfshinë koncertet me Hr Sinfonieorchester dhe Christoph Eschenbach, Orkestra Kombëtare e Belgjikës dhe Orkestra Simfonike Kombëtare RAI në Torino nën dirigjimin e Andrey Boreyko. Bouchkov performoi me NDR–Sinfonieorchester Hamburg, Orkestrën Kombëtare të Belgjikës, Orkestrën e Filharmonisë Mbretërore të Liezhës, Moskës, Filharmoninë Staatsorchester Rheinische dhe Simfoninë Düsseldorfer. Bouchkov performoi në koncertin themelues të serive "Essentials" të Orkestrës Mbretërore Concertgebouw. Në tetor të vitit 2016 debutoi në Wingmore Hall të Londrës, ku u shpërblye me çmimin London Music Masters. Sezoni 2017/2018 për Bouchkovin filloi me publikimin e albumin e tij të parë me punime të Ysaye, Chausson dhe të tija dhe në vitin 2017 u shpërmbyle me Diapason Découverte dhe u nominua për ICMA 2018. Pikat tjera me rëndësi përfshijnë vazhdimin e bashkëpunimit të tij me Düsseldorf Ballet, koncertet orkestrale duke përfshirë këtu MDR Orkestrën, Orkestrën e Filharmonisë Mbretërore të Liezhës, Orkestrën Kombëtare të Lorriane, si dhe recitalet dhe koncertet e muzikës kamertale në Paris, Lucern, Lugano, si dhe në Festivalin Rheingau. Marc Bouchkov sponzorohet nga Brigitte Feldtmann, e cila i dhuroi violinën punuar nga Jean Baptiste Vuillaume, Paris, 1865.

**ORKESTRA E FILHARMONISË SË KOSOVËS** u themelua pas luftës së fundit në Kosovë në vitin 2000 me iniciativë të disa muziktarëve të dalluar kosovar. Fillimisht si ansambël harkor e më vonë orkestër kamertale, Filharmonia e Kosovës paraqet padyshim vazhdimësinë e punës së ish Orkestrës Simfonike të Radiotelevizionit të Prishtinës veprimtaria e së cilës u shua me dhunë nga regjimi serb në vitin 1990. Pas konsolidimit të institucioneve shtetërore Filharmonia e Kosovës kalon në përkujdesje të Ministrisë së Kulturës e cila financon projektet koncertale dhe aktivitetin e rregullt të këtij institucioni të rëndësishëm muzikor. Orkestra e Filharmonisë së Kosovës ka realizuar një varg koncertesh simfonike dhe atyre operistike në kuadër të sezoneve koncertale vjetore. Në programet e orkestrës janë prezantuar veprat e një mori kompozitorësh botërorë dhe atyre shqiptarë të të gjitha orientimeve stilistike. Me Orkestrën Simfonike të Filharmonisë së Kosovës koncertuan një varg solistësh instrumental dhe vokal – mes tyre: Inva Mula, Ermonela Jaho, Tedi Papavrami, Pavel Vernikov, Kevin Kenner, Sihana Badivuku, Antonio Gashi, Venera Kajtazi, Lejla Pula, Kian Soltani, Petrit Çeku, Luka Sulic, Segei Nakariakov etj. si dhe dirigjentët: Bahri Çela, Toshio Yanagisawa, Pavle Deshpali, Ermir Krantja, Li Fi Fi, Marcio da Silva, Boian Videnoff, Alexander Prior, Baki Jashari, Peter Lukas Graf, Desar Sulejmani, Robert Lehrbaumer, Claudio Buchler, Bajar Berisha, Denis Shapovalov, Rene Gulikers, Nayden Todorov, Nathalie Marin, Bujar Llapaj, Hakan Sensoy etj.

**TOSHIO YANAGISAWA** – I lindur më 1971, Toshio Yanagisawa përfundojë studimet për dirigjim orkestral në "Ecole Normal de Musique de Paris". Në vitin 2002 ai u shpërblye me çmimin e dytë në Garat Ndërkombëtare të dirigjimit në Tokio. Tutje u ftua në festivalin prestigjioz "Verbier" të Zvicrës ku studioi me emra si James Levine dhe Kurt Mazur. Që nga ajo kohë, si dirigjent mysafir u ftua nga Filharmonia e Re Japoneze, Orkestra Filharmonike e Japonisë, Orkestra Filharmonike e Tokios, Orkestra Simfonike Metropolitane e Tokios, Orkestra Filharmonike e Qytetit të Tokios, Orkestra Simfonike e Sapporo–s, ajo e Sendai–t, Gunma–s, Nagoya–s, Kioto–s, Osaka–s, Orkestra Filharmonike e Kansai–t, Orkestra e Kanazawa–s, Orkestra Simfonike e Kyusyu–s etj. Yanagisawa ishte dirigjent permanent i Teatrit Kombëtar të Maqedonisë, në vitet 2005–2007. Në vitin 2007 u bë dirigjent kryesor i Filharmonisë së Kosovës me të cilën organizojë turne nëpër Japoni në vitin 2010. Në vitin 2007 ai e themelojë Orkestrën Kamertale Ballkanike për bashkë–mirëqenie të të gjithë kombeve të Ballkanit. Ai organizojë koncerte në Shkup, Prishtinë, Mitrovicë, Tiranë, Sarajevë, Beograd, Nju Jork, Vjenë dhe disa herë turne nëpër Japoni. Nga ana tjetër ai ka dirigjuar Orkestrën Simfonike të Beogradit, Filharmoninë e Sarajevës, Orkestrën Simfonike të Radiotelevizionit Shqiptar, Orkestrën Simfonike të Pragës, Orkestrën Simfonike "Hradec Kralove", Orkestrën Simfonike "West Bohemian", Operën e Stambollit dhe Orkestrën Simfonike të Shën Petersburgut. Aktualisht është drejtor muzikor i Orkestrës Kamertale të Ballkanit.

FILHARMONIA E KOSOVËS
KOSOVO PHILHARMONIC



E mërkurë **30** MAJ

**20:00** Amfiteatri i Ri i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare

## NATA AKUSMATIKE/ACOUSMATIC NIGHT

Koncert autorial Donika RUDI

## Donika RUDI Spacializuese/spacializer

**Donika Rudi**
Unspoken

**Donika Rudi**
Voyage vers l'inconnu

**Donika Rudi**
Emotion Machine

**Donika Rudi**
In between – Lux Sit

**Donika Rudi**
Unspoken

**Donika Rudi**
Echoes of the Crying Earth

Mysafir / Guest
**Armando Balice**
De l'or et du noir

**DONIKA RUDI**– Kompozitore kosovare e specializuarnëmuzikën elektroakustike dhe akusmatike lindi nw qershor 1982. Ka studiuar kompoziminnë Konservatorin e Muzikës në Gjenevë në dy drejtime:muzikëinstrumentale në klasën e Éric Gaudibert, Michael Jarrell dhe drejtimin e musikes elektroakustike me Rainer Boeschdhe Luis Naón. Studimet master i kreu në degën e kompozimit akusmatik në Konzervatorin Mbretëror të Muzikësnë Mons, nëklasën e Annette Vande Gornedhe Ingrid Drese.

Disa nga veprat e saja të rëndësishme janë: Baleti Kontemporan “Life in Slow Motion”,e cila u dha premierë në Teatrin Kombwtar të Prishtinës; “9” për trombon të amplifikuar & shiritmanjetik; “Aura I” përviolinë, violë, mezosoprano, soprano, perkusione & shiritmanjetik;“Emotion Machine” vepërakusmatike; “Within” (Emotion Machine II) dhe “Voyage versl'inconnu” mbështetur nga Ministria e Kulturës në Belgjikë – Federation Wallonie Bruxelles etj. Ajo gjithashtu ka kompozuar për teatër, filma, dokumentarë si dhe për libra për fëmijë.

Veprat e Rudit janë performuar në Portugali, Australi, Kolumbi, Itali, Kosovë, Shqipëri, Francë, Poloni, Belgjikë, Zvicër, Spanjë dhe Kanada, në Festivalet: “Musica Viva” Portugali, “Espace du Son” Belgjikë, “BIFEM, Bendigo International Festival of Exploratory Music ”Bendigo, Australi, Electro Belge: Panorama of electroacoustic music, Belgijike, “Deep Wireless” organizuar nga NAISA (New adventures in Sound Art) Toronto, Kanadë, “Territoires Acousmatiques” organizuar nga Alcôme,Francë, Festival ACOUMSA organizuar nga Acusma Association,Bari Itali , “ Zeppelin Expandit2012 ” Barcelona SoLímit” Barcelonë, Spanjë, Center of Electroacoustic Music”Gjenevë, Zvicër,etj.

Gjithashtu, veprat e Rudit janë transmetuar në Radio Spain – UNDÆ! Radio, France Musique (Christian Zanésiradioshow), Dutch National Radio (Café Sonore), “Sonema Lab”, Portugese National Radio (Arte Eletroacústica), “Phonogène”Radio HDR Rouen France, “Unspoken”, Emotion machine”, “The echoes of the crying Earth” , transmitted in Popscotch "Elektron" Beograd, Serbia,“Sonema Lab” live radio transmission – Bogota, Columbia

Që nga viti 2010 ajo është anëtare e shoqatës së kompozitorëvebelg të muzikës elektroakustike FEBEME–BEFEM; anëtare e shoqatës së kompozitorëvene KANADA – CEC SONUS si dhe është drejtoreshë artistike e Festivalit Ndërkombë të artë Prishtinës– ReMusica.Aktualisht ajo punon si ligjëruese në Universitetin e Prishtinës – Departamenti i Muzikës.



E enjte **31** MAJ

**20:00** Amfiteatri i Ri i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare

# NATA SHQIPTARE

*Kompozitorë dhe Interpretë shqiptarë*

**I Vepra pianistike dhe kamertale**
Klevis Gjergji, piano | Trio Sonore

**II All about wind … instruments!**
Kuintet pianistik: Meriton Ferizi, fagot/bassoon | Pëllumb Vula, klarinet/clarinet | Lejla Beqiri, flaut/flute| Bledar Bujupi, kornë / corno Albin Abazi, obo/oboe| Melos Buza, piano

**III Vepra korale**
SIPARANTUM CHOIR, dirigjent/conductor Memli Kelmendi

**Endri Sina**
Perhaps

**Dorian Cene**
..upon..

**Rafet Rudi**
Prishtina Blues

Klevis Gjergji, piano

**Bashkim Shehu**
Trio
Trio Sonore

**R.Schumann**
3 Romances (for oboe and piano op.94)
*Nicht Schnell | Einfach, innig*
*Nicht Schnell*

**B.Britten**
Six Metamorphoses (for oboe solo)
Albin Abazi, obo | Melos Buza, piano

**N.R.Korsakov**
Kuintet në B–Dur
*Allegro con brio*

**Hans Huber**
Kuintet I
Allegro con intimosentiment *Scherzo | Intermezzo | Finale*

Shkëlzen Baftiari, piano| Lejla Beqiri Vula, flaut | Pëllumb Vula, klarinetë Meriton Ferizi, fagot | Bledar Bujupi, korno

**Dafina Zeqiri Nushi**
Bum Çi–ke

**Memli Kelmendi**
Agnus Dei
Ater Umbra

**Mendi Mengjiqi**
Ut Nobis Detur

**Kreshnik Alickaj**
Siparantum

SIPARANTUM CHOIR, dirigjent Memli Kelmendi



Koncerti tematik **„NATA SHQIPTARE"** është i koncipuar në mënyrë që të shpalosë vepra të kompozitorëve nga Shqipëria dhe Kosova, varësisht formacionit dhe në të njejtën kohë të bëhet prezantimi i artistëve të rinjë nga këto dy vende. Koncerti është i ndërtuar mbi tri shtylla kryesore:

**Veprat pianistike dhe kamertale** – të autorëve shqiptarë me paraqitjen e **„Trio Sonore"**, ansambël frymor nga Kosova i themeluar ne vitin 2011, të cilët përpos repertoarit tyre me emra botëror, promovojnë veprat e autorëve shqiptarë. Në seksionin e veprave pianistike, vie **Klevis Gjergji** nga Shkodra i cili përfundoi studimet e larta ne *Centro Superior de Musica del Pais Vasco "Musikene"*, duke studiuar piano me Profesor Gustavo Díaz–Jerez, ish–student i Profesor Solomon Mikowsky në Manhattan School of Music, dhe improvizim me Profesor Loïc Mallié (ish–student i Oliver Messiaen). Gjatë viteve 2014–2015 ka mbajtur postin e Dekanit të Fakultetit të Muzikës,Akademia e Arteve –Shkodër, perderisa aktualisht është pedagog në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe pedagog i ftuar në Universitetin e Arteve, Tiranë.

**All about wind... instruments!** – vie si projekt ku në fokus ka instrumentet frymore dhe paraqitjen e kuintetit pianistik nga Kosova, i cili formacion për herë të parë u paraqit në vitin 2016 në skenën e vendit duke vazhduar pastaj edhe në skenat europiane: Zvicer dhe Francë duke sjellë kështu në pah premiera ballkanike dhe pak të njohura për vendin tonë.

